
 Republika e Kosovës	Drejtorati për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale		 Komuna e Istogut
	6 Nr.53/2019	Data: 24.04.2019	

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale, në bazë nenit 8 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212, Udhëzimit Administrativ Nr.14/2011, për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, shpall:

KONKURS

Titulli i vendit të punës: Mjek-e i/e Mjekësisë së Përgjithshme

Numri i referencës 53/019

Numri i Ekzekutuesve 2 (dy)

Niveli i Pagës: Koeficienti 7.2

Kohëzgjatja e Emërimit: Në kohë të pa caktuar

Orët e Punës: 40 Orë

Puna Provuese : 6 muaj

Punët dhe detyrat:

- Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen parësore;
- Kujdesi për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanet, medikamentët dhe i zbaton masat tjera shëruese;
- Ndhmon në parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët dhe popullatën në lidhje me pastërtinë dhe shëndetin në përgjithësi;
- Jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtim të pacientit;
- Përshkruan dhe administron medikamente;
- Udhëzon pacientët të specialistët mjekësorë dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore
- Përpilon me shkrim lidhur me punën dhe veprimet e tij;
- Ndërmerr aktivitetet për edukimin shëndetësorë të popullatës;
- Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikqyrësi në mbarëvajtjen e punës ku është i punësuar;
- Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçant në lëmin në të cilin është trajnuar
- Mban kujdestarinë sipas radhës dhe kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;
- Kryen detyra të veqanta në lidhje me profesionin e tij.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare- Fakulteti i Mjekësisë drejtimi Mjekësia e Përgjithshme.

Aftësit/ përvoja dhe atributet e tjera:

- Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
- Të jetë i licencuar;
- Përvoja e punës e dëshirueshme;
- Shkathtësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe dhënja e këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
- Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

Dokumentët e kërkua:

Diploma e fakultetit të Mjekësisë;
Çertifikatën e Licencës;
Dëshmi për përvojen e punës nëse ka;
Dokumenti i Identifikimit;
Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike , kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë nga dita e shpalljës** në mjetet e informimit.

Kandidatët e interesuar mund ti marrin aplikacionet çdo ditë pune , në Qendrën për Shërbim me Qytetar , kati i I-rë zyra nr.100 dhe aplikacionet e plotësuar dorëzohen në të njejtën zyre.

Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahet intervista nga komisioni .

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pa kompletuara nuk do të pranohen.



DREJTORI
Dr. Mujë Q. Osmanaj